



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

Monitoruesi i Prokurimit Publik

Parregullsitë ligjore të institucioneve dhe ndërmarrjeve publike
Janar-Dhjetor 2011



**CIVIL
RIGHTS
DEFENDERS**

Publikimi i këtij Raporti është përkrahur nga OSI/CRD.
Qëndrimet e shprehura në këtë Raport nuk reflektojnë
qëndrimet e OSI/CRD.

Përmbajtja

Përmbledhje Ekzekutive	3
Shkeljet nga ana e ministrive	4
Ministria e Drejtësisë	4
Ministria e Administratës Publike	5
Ministria e Infrastrukturës	6
Ministria e Kulturës	9
Ministria e Bujqësisë	10
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	11
Ministria e FSK-së	12
Ministria e Shëndetësisë	12
Shkeljet ligjore të ministrive në një tender	13
Shkeljet e Ndërmarrjeve Publike	14
Korporata Energjetike e Kosovës	15
Postë-Telekomi i Kosovës	16
Shkeljet nga ana e Komunave	18
Komuna e Lipjanit	18
Komuna e Suharekës	19
Komuna e Prishtinës	19
Komuna e Gjilanit	20
Komuna e Rahovecit	21
Komuna e Vitisë	22
Komuna e Graçanicës	22
Komuna e Podujevës	23
Komuna e Shtërpcës	23
Komuna e Kamenicës	24
Shkeljet ligjore të komunave në një tender	24
Rekomandimet	27
Falënderime	27
Rreth Lëvizjes FOL	27

Lista e Akronimeve/Shkurtesave

AK - Autoriteti Kontraktues

ANP - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës

BE - Bashkimi Evropian

CRD - Civil Rights Defenders

LPP - Ligji i Prokurimit Publik

KEK - Korporata Energjetike e Kosovës

KK - Kuvendi i Kosovës

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

MASHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

MAP - Ministria e Administratës Publike

MI - Ministria e Infrastrukturës

MD - Ministria e Shëndetësisë

MTPT - Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

MFP - Menaxhimi i Financave Publike

OE - Operatorë Ekonomik

OSI - Open Society Institute

OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit

PSH - Paneli Shqyrtues (Organ i OSHP-së)

PTK - Post-Telekomi i Kosovës

RPP - Rregullorja e Prokurimit Publik

ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje Ekzekutive

Ministritë kanë bërë shkelje të shumta ligjore në gjithsej tridhjetë (30) tenderë të ndryshëm. Ministria e Drejtësisë ka bërë shkelje ligjore në 5 tenderë, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Kulturës në katër (4) tenderë, Ministria e Forcës së Sigurisë dhe ajo e Bujqësisë në 3 tenderë, si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Zhvillimit Ekonomik në 2 tenderë. Ndërkaq, ministritë me shkelje ligjore vetëm në një tender janë Ministria e Financave, ajo e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Diasporës.

Pesëmbëdhjetë (15) prej këtyre tenderëve janë kthyer në ri-vlerësim, trembëdhjetë (13) janë kthyer në ri-tenderim dhe vetëm dy (2) tenderë është dashur të vazhdojnë aktivitetin e tyre të prokurimit dhe nuk janë lejuar të anulohen nga autoritetet kontraktuese - ministritë.

Ndërkaq, për shkaqe të parregullsive ligjore dhe moszbatimit të vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik është gjobitur Ministria e Shëndetësisë në vlerën e 30,000.00 eurove, Ministria e Infrastrukturës në vlerën e 25,000.00 eurove dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vlerën e 15,000.00 eurove.

Ndërmarrjet publike kanë bërë shkelje të shumta ligjore në nëntë (9) aktivitete të ndryshme prokurimi. Korporata Energjetike e Kosovës ka bërë shkelje në gjashtë (6) tenderë, ndërkaq Postë-Telekomi i Kosovës ka bërë shkelje ligjore në tre (3) aktivitete të ndryshme prokurimi. Prej tyre 3 kanë shkuar në ri-tenderim, një nuk është lejuar të anulohet dhe pesë tenderë të tjerë në ri-vlerësim.

Gjatë këtij intervali kohor është gjobitur edhe Postë-Telekomi i Kosovës në shumën e 20,000.00 eurove, ndërkaq menaxheri i prokurimit është gjobitur në vlerën e 2,000.00 eurove.

Komunat gjatë vitit 2011 kanë bërë shkelje të shumta ligjore në gjithsej 37 aktivitete prokurimi. Njëzetekatër (24) prej tyre janë kthyer në ri-vlerësim, 11 në ri-tenderim dhe vetëm 2 nuk janë lejuar të anulohen nga autoritetet kontraktuese. Komunat më me shumë shkelje janë Komuna e Lipjanit dhe ajo e Suharekës, me nga katër (4) tenderë. Pastaj vijnë komuna e Prishtinës, e Gjilanit, e Rahovecit dhe ajo e Vitisë me nga tre (3) tenderë. Ndërkaq, me nga dy (2) tenderë janë Komuna e Graçanicës, e Podujevës, e Shtërpçës dhe ajo e Kamenicës. Dhe me nga një (1) tender të vetëm janë Komuna e Pejës, e Ferizajt, e Prizrenit, e Kaçanikut, e Istogut, e Klllokotit, e Fushë Kosovës, e Mitrovicës dhe ajo e Klinës.

Ndërkaq, për shkak të shpërfilljes së vendimit të OSHP-së në rastin e tenderit “furnizim dhe montim me pajisje për monitorim të rrugëve të Graçanicës”, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik e ka gjobitur Komunën e Graçanicës në vlerën e 6,000.00 eurove.

Shkeljet nga ana e Ministrive

Ministritë kanë bërë shkelje të shumta ligjore në gjithsej 30 tenderë të ndryshëm. Ministria e Drejtësisë ka bërë shkelje ligjore në 5 tenderë të ndryshëm, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në 4 tenderë, Ministria e Forcës së Sigurisë dhe ajo e Bujqësisë në 3 tenderë, si dhe Ministria e Shëndetësisë dhe ajo e Zhvillimit Ekonomik në 2 tenderë. Ndërkaq, ministritë me shkelje ligjore vetëm në një tender janë Ministria e Financave, ajo e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Diasporës.

Pesëmbëdhjetë (15) prej këtyre tenderëve janë kthyer në ri-vlerësim, trembëdhjetë (13) janë kthyer në ri-tenderim dhe vetëm dy (2) tenderë është dashur të vazhdojnë aktivitetin e tyre të prokurimit.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë ka bërë shkelje ligjore në pesë (5) tenderë të ndryshëm. Prej tyre tri janë kthyer në ri-vlerësim, ndërkaq vetëm njëri në ri-tenderim. Organi Shqyrtues i Prokurimit ka urdhëruar Ministrinë e Drejtësisë që aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me mish dhe produkte nga mishi” ta rivlerësojë nga fillimi.¹ Fillimisht Kompania “Apetit” e kishte fituar tenderin në vlerë prej 502800.00€, por më pastaj OSHP-ja e ka rikthyer atë në ri-vlerësim -- pas ankesës së operatorit tjetër ekonomik² i cili kishte ofertuar çmimin më të lirë në vlerë prej 363355.00€. Kjo kompani ishte ankuar pasi që banka e kishte specifikuar garancionin bankar vetëm për një ditë, ndërkaq është dashur të jetë 90 ditë -- sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Më pastaj Autoriteti Kontraktues (MD) ka kërkuar interpretim nga ana e KRRP-së, por OSHP-ja përmes një urdhëresë ka konstatuar se MD është dashur ta zbatojë vendimin e saj përfundimtar dhe assesi të kërkojë interpretim nga ana e KRRP-së.³ Me këtë rast OSHP-ja ka kërkuar nga Menaxhmenti i Autoritetit Kontraktues që në rast të mos-zbatimit të këtij vendimi ndaj menaxherit të prokurimit të aplikohen masat disiplinore konform dispozitave të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë për bishtnim të përmbarimit të vendimit të OSHP-së dhe të kërkojë nga Paneli Shqyrtues të shqiptojë një gjobë në vlerë prej 5000.00 €.⁴ Duke parë tërë këtë situatë, ministri i Drejtësisë e ka anuluar tërësisht këtë tender në konsultim me Agjencinë Kundër Korrupsion dhe Komisionin Rregullativ të Prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë muajit prill ka lëshuar dy urdhëresa për Ministrinë e Drejtësisë. Me këto urdhëresa OSHP-ja ka urdhëruar Ministrinë e Drejtësisë që ta respektojë vendimin e saj për ri-vlerësim të aktivitetit të prokurimit “Furnizimi me mish dhe produkte nga mishi”.⁵ Fillimisht Kompania “Apetit” e kishte fituar tenderin në vlerë prej 502800.00€, por më pastaj OSHP-ja e ka rikthyer atë në ri-vlerësim -- pas ankesës së operatorit tjetër ekonomik⁶ i cili kishte ofertuar çmimin më të lirë në vlerë prej 363355.00€. Kjo kompani ishte ankuar pasi që banka e kishte specifikuar garancionin

¹ Nr. i protokollit 34/11, Organi Shqyrtues i Prokurimit, 30 mars, 2011, fq.1

² N.T.P. Hajdini Comerc

³ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Me gjerësisht shih <http://www.ks-gov.net/krpp/>

⁴ Nr. i protokollit 34/11, Organi Shqyrtues i Prokurimit, 30 mars, 2011., fq. 2

⁵ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Nr. i protokollit 34/11, 30 mars, 2011, fq.1

⁶ N.T.P. Hajdini Comerc

bankar vetëm për një ditë, ndërkaq është dashur të jetë 90 ditë sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Më pastaj Autoriteti Kontraktues (MD) ka kërkuar interpretim nga ana e KRRP-së, por OSHP-ja përmes një urdhëresë ka konstatuar se MD është dashur ta zbatojë vendimin e saj përfundimtar dhe assesi të kërkojë interpretim nga ana e KRRP-së.⁷ Me këtë rast OSHP-ja ka kërkuar nga Menaxhmenti i Autoritetit Kontraktues që në rast të moszbatimit të këtij vendimi ndaj menaxherit të prokurimit të aplikohen masat disiplinore konform dispozitave të Ligjit mbi Shërbyesit Civilë për bishtnim të përbarimit të vendimit të OSHP-së dhe të kërkojë nga Paneli Shqyrtues të shqiptojë një gjobë në vlerë prej 5000.00 €. ⁸ Duke parë tërë këtë situatë, ministri i Drejtësisë e ka anuluar tërësisht këtë tender në konsultim me Agjencinë Kundër Korrupsion dhe Komisionin Rregullativ të Prokurimit. Duke parë që MD nuk po e zbaton vendimin e OSHP-së, kjo e fundit ka lëshuar këto dy urdhëresë të cilat e paralajmërojnë autoritetin e tillë kontraktues për ndëshkim me 5000.00 Euro dhe masa disiplinore ndaj zyrtarit të prokurimit të kësaj ministrie.⁹

Ndërkaq, gjatë tre mujorit të fundit Ministria e Drejtësisë ka bërë shkelje ligjore në tre tenderë të ndryshëm. Për shkak të shkeljeve ligjore, respektivisht të neneve 50 dhe 60 të LPP-së, OSHP ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-vlerësim. Ndërkaq, për shkak të parregullsive të shumta që e kanë shoqëruar tenderin “Renovimi i Qendrës Korrektuese në Smerkovicë” është vendosur që ky tender të kthehet në ri-tenderim. Paneli Shqyrtues ka konstatuar se vlefshmëria e ofertave të operatorëve ekonomikë konkurrues kishte skaduar dhe nuk ishte ripërtërirë siç parashihet me Rregulloren për Prokurim Publik - pjesa B, neni 19.2. Mirëpo, pasi që MD kishte shprehur interesimin e saj ky tender ishte kthyer në ri-tenderim, por për shkak të shkeljes së neneve 59 dhe 60 të LPP-së është dashur të shkojë sërisht në ri-vlerësim.

Ministria e Administratës Publike

Ministria e Administratës Publike ka bërë shkelje në katër tenderë të ndryshëm. Prej tyre 2 janë kthyer në ri-vlerësim dhe dy tenderë tjerë në ri-tenderim. Shkeljet e para kanë qenë në kuadër të tenderit “Furnizim me derivate të naftës për nevojat e MAP-it”. Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të Komisionit Vlerësues, konstatimeve të cekura në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, deklaratës së përfaqësuesit të operatorit ekonomik “Kastrioti Petroll” dhe sqarimeve të dhëna gjatë seancës nga të dyja palët ka konstatuar se tenderi në fjalë të kthehet në ri-vlerësim. PSH ka konstatuar se MAP-i ka bërë shkelje duke e vlerësuar si të papërgjegjshëm operatorin ekonomik ankues gjoja se i mungon “kontrata për furnizime në pikën e kërkuar në Ferizaj”.¹⁰

Ministria e Administratës Publike ka bërë shkelje edhe me rastin e tenderit “Mirëmbajtja higjienike dhe teknike për ndërtesat qeveritare - Pjesa 1, Pjesa, 2 dhe Pjesa 4”. Kjo ministri ka bërë shkelje të dispozitave ligjore, respektivisht të nenit 61 (Tender i ulët jashtë normales) dhe 69 (Aftësia teknike dhe/ose profesionale) të LPP-së gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Duke parë shkeljet e tilla operatori ekonomik “Uni Project” ishte

⁷ Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Me gjerësisht shih <http://www.ks-gov.net/krrp/>

⁸ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Nr. i protokollit 34/11, 30 mars, 2011, fq. 2

⁹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Udheres_Fur_Mish.pdf

¹⁰ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Nr. 04/11, 31 Janar, 2011, fq. 2-3

ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Ky i fundit, bazuar në ekspertizën e ekspertit shqyrtues ka marrë vendim që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**. Me këtë vendim është pajtuar edhe autoriteti kontraktues pranë MAP-it.¹¹ Përveç këtyre shkeljeve, MAP ka bërë edhe shkelje të tjera në lidhje me tenderin “Ndërtimi i Ndërtesës së Forcës së Sigurisë së Kosovës”. Pas ankesës së operatorit ekonomik “Al-Ber” për parregullsi lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe pas ekspertizës së ekspertit shqyrtues OSHP-ja ka nxjerrë vendim që këtë tender ta kthejë në **ri-tenderim**. Arsyetimi për një vendim të tillë ka qenë mos respektimi i nenit 7.4 (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca), nenit 69 (Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale), nenit 6.1 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti). Përveç shkeljeve të tilla ligjore, ky autoritet kontraktues ka bërë shkelje edhe nenit 11.3 të Rregullores “B” të Prokurimit Publik.¹²

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka lëshuar dy njoftime në adresë të Ministrisë së Administratës publike: njëri për shkeljet e bëra gjatë hartimit të dosjes së tenderit “avancimi dhe mirëmbajtja e sistemit të gjendjes civile në kuadër të E-qeverisjes” dhe tjetri për “mirëmbajtjen higjienike dhe teknike të ndërtesave të qeverisë”. Në rastin e parë ankesa është bërë nga operatori ekonomik “CSE”, ku më pastaj OSHP e ka caktuar ekspertin shqyrtues për ta vërtetuar ankimin e kësaj kompanie. Sipas ekspertit shqyrtues autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca) dhe i rekomandon atij që mos të bëjë eliminimin e ofertuesve të cilët nuk i kanë këto referenca. Pas marrjes së këtij raporti, MAP është pajtuar me mendimin e ekspertit dhe ka premtuar se do t’i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi. Ndërkaq në rastin e dytë ankesa është bërë nga ofertuesi “MSS”. Pas kësaj ankesë OSHP-ja e ka caktuar ekspertin shqyrtues, i cili ka konstatuar shkelje të shumta ligjore: neni 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), 7 (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca), 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës), 61 (Tenderët Ulët Jashtë Normales) dhe 63 (Siguria e Ekzekutimit) të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Me këtë mendim të ekspertit është pajtuar edhe Ministria e Administratës Publike. Kështu që, ky aktivitet i prokurimit është kthyer në **ri-tenderim**.

Ministria e Infrastrukturës

Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje ligjore në katër (4) aktivitete të ndryshme prokurimi. Në muajin janar të këtij viti OSHP-ja ka nxjerrë një urdhëresë plotësuese për MTPT për tenderin e vitit të kaluar (2010) “mbikëqyrja e ndërtimeve dhe shërbimet e menaxhimit, Rruga 7: Autostrada Morinë-Merdare”. Sipas kësaj urdhëresë MTPT-ja është dashur ta nënshkruajë kontratën me operatorin ekonomik të shpallur fitues “Merlino Progetti&Politecnica”.¹³ Në anën tjetër MTPT ka “arsyetuar” mos-nënshkrimin e saj me këtë kompani për vetë faktin se në deklaratën e saj bankare nuk figuron asnjë e dhënë lidhur me vlerën financiare të këtij konsorciumi. Sipas kësaj ministrie është dashur të anulohet tërësisht tenderi. Duke parë që Autoriteti Kontraktues nuk po i respekton vendimet e OSHP-së, atëherë kjo e fundit ka nxjerrë një vendim ndëshkues financiar në

¹¹ http://oshp.rks-qov.net/repository/docs/vendimet/2011/mirem_hiqjin_tek_nder_korrik11.pdf

¹² http://oshp.rks-qov.net/repository/docs/vendimet/2011/Mir_Higj_Qever.pdf

¹³ Po aty, Nr. 351/10, 6 Qershor, 2011, fq. 1

vlerën prej **20.000.00 Euro**.¹⁴ Edhe pse është dashur që edhe zyrtari i prokurimit të ndëshkohet financiarisht dhe heqjen e të drejtës së ushtrimit të funksionit publik, ai ka mbetur i paprekshëm.

Ministria e Infrastrukturës më datën 15 qershor 2011 ka shpallur fitues kompaninë “Hill International” (6 milionë e 950 mijë euro) në tenderin për mbikëqyrjen e punimeve në autostradë. Në njoftimin për dhënie të kontratës të kësaj ministrie figuron se fitues është shpallur dega në Luksemburg e kësaj kompanie amerikane. Dy zëvendës presidentë të kësaj kompanie në Amerikë kanë punuar vite më radhë në korporatën amerikane “Bechtel”, e cila njëherazi është kontraktuar për ndërtimin e autostradës¹⁵. Deri te zgjedhja e kësaj kompanie kishte shkuar afër një vit për shkak të problemeve me tenderin e mbikëqyrjes. Në fillim të vitit të kaluar ishte shpallur fituese pikërisht “Hill International”, pasi komisioni vlerësues i kësaj ministrie e kishte vlerësuar me më së shumti pikë - ani pse e ka pasur çmimin prej më se 8 milionë eurosh me të shtrenjtë sesa ofertuesi me çmimin më të lirë. Kjo kompani kishte marrë 99 pikë nga komisioni vlerësues edhe pse oferta e saj kishte vlerën e 11 milionë eurove, që është për 9 milionë më shumë se ofertuesi “Grusamar” nga Spanja, e cila kishte marrë vetëm 80 pikë me çmim të ofertës prej 2 milionë e 750 mijë eurosh. Sipas dosjes së tenderit 80 pikë merreshin për plotësimin e kriterëve teknike, ndërsa 20 pikë për çmimin më të lirë. Kompania “Hill” kishte marrë 19 pikë për çmimin më të lirë edhe pse kishte ofertën dy-tre fish më të shtrenjtë se kompanitë tjera.

MTPT-ja kishte anuluar këtë tender pasi kishte kryer punën Komisioni Vlerësues. Si arsye e anulimit të tenderit në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, në prill MTPT-ja kishte shënuar se “anulimi është i nevojshëm për shkak të arsyeve objektive dhe të demonstrueshme, të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit”¹⁶. Ky tender është shoqëruar edhe me shkelje procedurale. Hapja e ofertave është bërë me pesë muaj vonesë, më saktësisht më 6 prill të vitit 2010. Data e shpalljes së këtij tenderi ka qenë më 12 shtator të vitit të 2009, ndërsa data e mbylljes ka qenë më 3 nëntor të vitit 2009. Ndërkaq në korrik të vitit 2010 fitues ishte shpallur konsorciumi i kompanive italiane “Merilino Progeti e Politecnica”, cili kërkonte 6.8 milion euro.¹⁷ Kontrata me italianët nuk ishte nënshkruar edhe disa muaj pas shpalljes së fituesit. Organi Shqyrtues i Prokurimit pati dënuar MTPT-në me një gjobë prej 20 mijë eurosh për shkak të mos nënshkrimit të kontratës me fituesin e tenderit.¹⁸ Ministri i kësaj ministrie kishte dhënë arsyetimin se MTPT-ja ishte duke verifikuar dokumentacionin e kësaj kompanie - pasi kishte krijuar dyshime në vërtetësinë e tyre. Ndërkaq Ministria e

¹⁴ Po aty, Nr. 351/10, 15 Mars, 2011, fq. 1-4

¹⁵ Hill International (2008). Hill International Promotes Two Professionals to Vice President in Dubai. Marlton, NJ & Dubai. http://files.shareholder.com/downloads/HINT/1327672254x0x209745/e6d11aed-a3cb-4807-aaec2c0af76c119f/HIL_Neës_2008_6_30_General.pdf

¹⁶ Ministria e Transportit dhe Postë -Telekomunikacionit (2010). Njoftim anulimi: “MBIKËQYRJA E NDËRTIMEVE DHE SHËRBIMET E MANAXHIMIT RRUGA NR.7, AUTOSTRADA MORINË-MERDARE”. Prishtinë. <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtLIDcVieëNotices&IDc29194>

¹⁷ Ministria e Transportit dhe Postë -Telekomunikacionit (2010). Njoftim anulimi: “MBIKËQYRJA E NDËRTIMEVE DHE SHËRBIMET E MANAXHIMIT RRUGA NR.7, AUTOSTRADA MORINË-MERDARE”. Prishtinë. Me hollësisht shih <http://krpp.rks.gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtLIDcVieëNotices&IDc32353>

¹⁸ Organi Shqyrtues i Prokurimit (2011). Vendimi 351/10: Mbikëqyrja e ndërtimeve dhe shërbimet e menaxhimit, rruga nr. 7, Autostrada Morinë-Merdare. Prishtinë. http://oshp.rks.gov.net/repository/docs/vendimet/2011/urdh_mtpt_mirem_autom_jan11.pdf

Infrastrukturës ka ngritur padi kundër OSHP-së në Gjykatën Supreme duke kundërshtuar vendimin e saj i cili i obligon me pagesë prej 20 mijë eurosh për shkak të shkeljeve të Ligjit të Prokurimit Publik.

Përveç kësaj, Ministria e Infrastrukturës gjatë muajit maj ka shpërblyer me tender prej 1.8 milionë eurosh kompaninë “Arda Rei” - për të përmbyllur punimet në ndërtimin e rrethrotullimit”.¹⁹ Megjithëse për këtë tender kishin konkurruar edhe 12 kompani të tjera, autoriteti kontraktues ka përzgjedhur kompaninë “Arda Rei” - ani pse punët në tenderin e parë nuk i kishte kryer sipas afatit kohor prej 18 muajsh. Ministria e Transportit kishte shpërblyer me kontratë këtë kompani edhe në tetor të vitit 2008 në një tender vlera e të cilit ishte mbi 12.7 milionë euro. Kontrata e parë kishte të bënte me të njëjtën punë: ndërtimin e rrethrotullimit në hyrje të Prishtinës, ndërsa kjo kompani për të kryer këtë punë ishte në konzorcium me kompaninë “Dinarik”. Sipas kontratës ishte dashur që punimet të përfundonin pas 18 muajsh, por nuk u kryen në këtë kohë. Po ashtu me kompaninë “Arda Rei” dy vite më vonë më 25.08.2010 Ministria e Transportit ka lidhur një aneks kontratë për këtë punë. Ndonëse afati i punimeve ishte përcaktuar 30 ditë punë, projekti nuk përfundoi as sipas aneks kontratës.

Po ashtu, tenderi për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve nacionale dhe rajonale të Ministrisë së Infrastrukturës (MI) është anuluar nga ana e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP)²⁰. Ky tender ishte mbyllur më 15 prill 2011, ndërsa hapja e ofertave ishte bërë tri ditë më vonë, ku fitues ishin shpallur nëntë kompani, derisa në garë ishin 33 sosh. Më vonë, katër kompani u ankuan në OSHP. Kompanitë që janë ankuar janë “Magjistrallja”, “EuroKos & Drenica”, kompania “Shkoza & Marsi” si dhe kompania “Bejta Commerce”. OSHP-ja pas ankesave të këtyre kompanive anuloi këtë tender, që peshon mbi 10 milionë euro, me arsyetimin se kjo ministri ka shkelur dy nene të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). Sipas vendimit të OSHP-së, MI ka shkelur nenin 7 të LPP-së, që rregullon barazinë në trajtim të kompanive në garë për tender, dhe nenin 27 të këtij ligji, që trajton kriteret e dosjes së tenderit. Esenca e shkeljes është përdorimi i kriterëve eliminuese. Sipas ekspertëve MI-ja tek kriteret nuk është dashur që të kërkojë vetëm kompani që kanë përvojë në mirëmbajtjen e rrugëve, por të lërë mundësinë të hapur që në këtë tender për mirëmbajtjen e rrugëve të pranohen referenca edhe nga kompanitë që s’kanë bërë këtë punë në tre vjetët e fundit, por që janë edhe vetëm kompani ndërtuese. Ky tender është **ri-shpallur** (ri-tenderim), por nuk është dhënë ndonjë njoftim publik që janë marrë masa ndaj dikujt në Ministrinë e Infrastrukturës për shkeljet e evidentuara.

Ndërkaq, gjatë tre muajve të fundit Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje ligjore në tre tenderë të ndryshëm. Në tenderin “Sinjalizimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët magjistrale dhe rajonale të Kosovës për vitin 2011 - pjesa 1, 2, 4, 5, 6, 7 dhe 8” MI ka shkelur nenet 7, 52, 59 dhe 60 të Ligjit të Prokurimit Publik. Bazuar në shkeljet e tilla ligjore Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-

¹⁹ Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (2010). Njoftim për kontratë: NDËRTIMI I RRETH-RROTULLIMIT NË UDHËKRYQIN E RRUGËVE NACIONALE M9 DHE M2 NË PRISHTINË, FAZA E II-TË. Prishtinë.

<http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PIDcNotices&LIDc1&PCIDc-1&CtIIDcVieëNotices&IDc44193>

²⁰ Organi Shqyrtues i Prokurimit (2011). Vendimi PSH.nr. 77/78/79/81/11. Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve nacionale dhe regjinale të Republikës së Kosovës lidhur me regjionin 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9. Prishtinë.

<http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/MIRmb-Ver-Dimer.pdf>

vlerësim. MI ka bërë shkelje ligjore po ashtu në tenderin “Ndërtimi i rrugës Kuqishtë-Bogë - L=8509m”, ku është vendosur që të kthehet në **ri-tenderim**. Autoriteti Kontraktues, në këtë rasti MI, ka bërë shkelje të nenit 32, pika 4 të LPP-së, ku ceket se “nëse gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit pranohen më pak se dy ofertues të përgjegjshëm, ose kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, AK duhet të anulohet aktivitetin e prokurimit”. Përveç shkeljes së nenit 32, MI ka shkelur edhe nenet 59 dhe 60 të LPP-së, me ç’rast tenderi në fjalë është anuluar. Gjithashtu, Ministria e Infrastrukturës ka bërë shkelje ligjore edhe në tenderin “Furnizim me kripë industriale për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve nacionale dhe regjionale të Kosovës për sezonin dimëror 2011/2012. Ky tender është vendosur të kthehet në **ri-vlerësim** për shkak të shkeljes së nenit 59 të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Gjatë kësaj kohe Organi Shqyrtues i Prokurimit ka gjobitur këtë ministri me 5,000.00 euro për mospërfillje të vendimit të saj në tenderin “sanimi i rrugës regjionale R-105, segmenti Klinë-Brojë L=4.0km” dhe ka kërkuar që të merren masa për zyrtarin kryesore të prokurimit.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

Ministria e Kulturës ka bërë shkelje ligjore në katër tenderë të ndryshëm. Me rastin e tenderit “Ndërtimi i palestrës sportive në Dardanë-Faza II” MK ka bërë shkelje të Ligjit mbi Prokurimin Publik, gjegjësisht të nenit 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit), nenit 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) dhe atij 19 (Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar). Shkeljet e tilla kanë qenë si rrjedhojë e mos-përfilljes së procedurave të prokurimit publik, neglizhencës së autoritetit kontraktues dhe konfuzionit të shkaktuar nga qeveria e Kosovës - për shkak të situatës së paqartë nëse edhe ministrat duhet t’i nënshkruajnë tenderët me vlerë të mesme dhe të madhe. Ky tender që nga fillimi i tij është shoqëruar me parregullsi të shumta. Në fillim është cilësuar si “tender për punë me vlerë të madhe”, ndërkaq më vonë është kualifikuar si “tender me vlerë të mesme”. Megjithatë, kjo shkelje nuk është vlerësuar si më e rënda nga eksperti shqyrtues, meqë anulimi i këtij tenderi nga autoriteti kontraktues, në kundërshtim me dispozitat ligjore ekzistuese, ka qenë vendimtar që Paneli Shqyrtues i OSHP-së ta rikthej në **ri-vlerësim**. Anulimi i tillë bie ndeshë edhe me nenin 6 të LPP-së, meqë dëmton ekonomicitetin dhe efikasitetin e operatorëve ekonomikë dhe autoritetit kontraktues - Ministrisë së Kulturës.²¹

Me rastin e tenderit “Ndërtimi i palestrës sportive në Dardanë-Faza II” MK ka bërë shkelje përsëri të Ligjit mbi Prokurimin Publik, gjegjësisht të nenit 57 (Sigurimi i Tenderit). Ky tender që nga fillimi i tij është shoqëruar me parregullsi të shumta. Në fillim është cilësuar si “tender për punë me vlerë të madhe”, ndërkaq më vonë është kualifikuar si “tender me vlerë të mesme”. Megjithatë, kjo shkelje nuk ishte vlerësuar si më e rënda nga eksperti shqyrtues, meqë anulimi i këtij tenderi nga autoriteti kontraktues, në kundërshtim me dispozitat ligjore ekzistuese, kishte qenë vendimtar që Paneli Shqyrtues i OSHP-së ta rikthente në **ri-vlerësim**. Anulimi i tillë sipas OSHP-së kishte rënë ndeshë edhe me nenin 6 të LPP-së, meqë e dëmton ekonomicitetin dhe efikasitetin e operatorëve

²¹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Nder_Pale_spor_Dard_II.pdf

ekonomikë dhe autoritetit kontraktues - Ministrisë së Kulturës.²² Andaj, OSHP-ja kishte vlerësuar atëkohë se AK me rastin e këtij tenderi kishte bërë shkelje të nenit 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit), nenit 6 (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti) dhe atij 19 (Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar). Kështu që, ky tender (i rievlerësuar) përsëri ka shkuar në ri-vlerësim.

Gjithashtu, gjatë kësaj kohe MKRS-ja ka bërë shkelje ligjore edhe në dy tenderë të ndryshëm. Në tenderin “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Drenasit - Faza e II-të” është bërë shkelja e nenit 32.4, ku ceket se “nëse gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit pranohen me pak se dy tenderë të përgjegjshëm, ose kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, Autoriteti Kontraktues duhet të anulojë aktivitetin e prokurimit”. Ky tender është kthyer në ri-tenderim. Ndërkaq, në tenderin tjetër “Ndërtimi i Palestrës Sportive në Komunën e Klinës - Faza e II-të” janë bërë shkeljet e neneve 7, 51, 59 dhe 60 të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Edhe ky aktivitet i prokurimit është kthyer në ri-tenderim.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë ka bërë shkelje të dispozitave ligjore në tre (3) aktivitete prokurimi. Shkelja e parë ka ndodhur në tenderin “Komosacioni i Tokave në Komunën e Gjakovës”. Fillimisht kompania ankuese (Intershped AK nga Ferizaji) kishte deponuar ankesat e saj dhe më pastaj Organi Shqyrtues i Prokurimit ka caktuar ekspertin shqyrtues për të mbledhur faktet dhe për ta konstatuar nëse ka pasur apo jo shkelje. Pas dëgjimit të provave: nga pala ankuese, autoriteti kontraktues dhe ekspertizës së ekspertit shqyrtues, Paneli Shqyrtues ka vendosur që tenderin e lartpërmendur ta ri-vlerësojë në fillimi për shkak të shkeljeve të neneve 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) dhe 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës). Paneli Shqyrtues ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka bërë vlerësimin e drejtë të poenëve lidhur me stafin profesional, pajisjet profesionale dhe me referencat e prezantuara nga ana e operatorit ekonomik ankues. PSH njashtu ka konstatuar se operatori ekonomik që ka marrë më shumti pikë nuk ka disponuar mjete të mjaftueshme për shkak se mjetet e tilla kanë qenë në pronësi të Institutit të Gjeodezisë në Prishtinë.²³

Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik gjatë muajit shtator e ka gjobitur Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në vlerën prej **15,000.00 Euro**.²⁴ Ky vendim është nxjerrë për moszbatim të vendimit paraprak të këtij institucioni në lidhje me tenderin “Komosacioni i Tokave në Komunën e Gjakovës”.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se Ministria e Bujqësisë me rastin e vlerësimit të ofertave nuk ka bërë vlerësimin e drejtë të poenëve lidhur me stafin profesional, pajisjet profesionale dhe me referencat e prezantuara nga ana e operatorit ekonomik ankues. PSH njashtu ka konstatuar se operatori ekonomik që ka marrë më shumti pikë nuk ka disponuar mjete të mjaftueshme për shkak se mjetet e tilla kanë qenë në pronësi të Institutit të

²² http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Nder_Pale_spor_Dard_II.pdf

²³ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/komosa_toka_gjki.pdf

²⁴ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/studim_shpernd_shtat11.pdf

Gjeodezisë në Prishtinë.²⁵ Ndërkaq, komisioni ri-vlerësues me datën 21 korrik 2011 ka konstatuar se nga 7 oferta të operatorëve ekonomikë, 6 kanë qenë të përgjegjshme dhe vetëm 1 e përgjegjshme, duke harruar se komisioni i mëparshëm 6 kompani i kishte shpallur të papërgjegjshme, ndërsa vetëm 1 të përgjegjshme. Më pastaj, autoriteti kontraktues ka bërë njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit, duke mos përfillur rekomandimet e Panelit Shqyrtues. Duke parë këtë parregullsi ligjore, OSHP ka nxjerrë një urdhëresë me 15 gusht 2011 për **mos-anulim** të këtij aktiviteti të prokurimit, por të bëhet ri-vlerësimi konform dispozitave ligjore. Zbatimi i kësaj urdhëresë është dashur të bëhet brenda 5 ditëve, ndërsa AK nuk kishte përfillur këtë urdhëresë dhe për këtë shkak OSHP e ka shqiptuar dënimin prej 15,000.00 euro.

Përveç kësaj shkelje, MBPZHR ka bërë edhe shkelje të tjera në tenderin “ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Mushtisht dhe pragun e pendës së ujitjes në fshatin Poslisht”. Në këtë tender autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca) dhe nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve). Me këtë rast OSHP-ja ka miratuar vendimin e saj për **ri-tenderim** të këtij aktiviteti të prokurimit.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Ministria e Zhvillimit Ekonomik përgjatë periudhës njëvjeçare ka bërë shkelje të shumta ligjore në tre tenderë të ndryshëm. Shkeljet e para janë konstatuar në tenderin “Zbatimi i masave eficientë të energjisë në institucionet publike në kuadër të realizimit të planit kombëtar të EE, sipas kërkesave të BE-së dhe TKE-së - Zbatimi i vendimit të qeverisë për poqa kursyes - ndriçimi i rrugëve”. Në rastin e këtij tenderi autoriteti kontraktues ka diskriminuar operatorët ekonomikë, sepse në mënyrë të paligjshme ka kërkuar nga ofertuesit që qarkullimin financiar ta kenë në vlerë prej 700,000.00 vetëm për vitin 2010. Më pastaj, kompania “Multi Business Group” është ankuar në OSHP, me ç’rast kjo e fundit e ka njoftuar Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik që qarkullimi financiar të jetë për tri vitet e fundit, e jo siç është kërkuar vetëm për vitin 2010.²⁶ Ky tender është kthyer në **ri-vlerësim**. Përveç kësaj, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka bërë shkelje edhe në tenderin “studimi mbi shpërndarjen e konsumit energjetik në sektorin e amvisërisë dhe mundësitë e përmirësimit të eficientë të energjisë”. Në këtë tender MZHE ka bërë shkelje të nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), pasi që operatorin ekonomik nga Kroacia, “Energetski Institut Hrvoje Poshar”, e ka shpallur padrejtësisht të papërgjegjshme - me arsyetimin se garancionin bankar nuk e ka pasur të vulosur. Mirëpo, edhe pse AK ka ngulur këmbë se nuk ka bërë shkelje, duke u bazuar edhe në ekspertizën e ekspertit shqyrtues, Paneli Shqyrtues ka nxjerrë vendim për **ri-vlerësimin** e këtij tenderi, duke qenë se ministria në fjalë e ka eliminuar pa të drejtë nga konkurrenca.²⁷ Ndërkaq, shkelja tjetër është bërë në aktivitetin tjetër të prokurimit “programi mbështetës - auditimi i ndërtesave publike”. Pas analizimit të fakteve, të dhëna nga operatori ankues,

²⁵ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/komosa_toka_gjki.pdf

²⁶ oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/zbatim_masave_be_gusht11.pdf

²⁷ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/studim_shpernd_shtat11.pdf

nga autoriteti kontraktues, eksperti shqyrtues dhe KRPP, Paneli Shqyrtues ka vendosur që tenderin në fjalë ta kthejë në **ri-tenderim**.²⁸

Ministria e Forcës së Sigurisë

Korrik-Shtator - Ministria e FSK-së ka bërë shkelje në aktivitetin e prokurimit “shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve - xhip mitsubishi për nevojat e MFSK dhe FSK”.²⁹ Pas ankesës së operatorit ekonomik “Allmakes Global Services (AGS), Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka caktuar ekspertin shqyrtues, i cili ka konstatuar shkelje të mëdha gjatë këtij vlerësimit të këtij tenderi:

- Nuk kanë qenë së paku tre operatorë të përgjegjshëm;
- Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka pasur autorizim nga prodhuesi e as nga distributori i autorizuar;
- Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmime të ulëta jashtë normales për artikuj/pjesë të ndryshme të automjeteve

Megjithatë, MFSK nuk është pajtuar me raportin e ekspertit, me ç’rast është mbajtur edhe seanca dëgjimore, ku palët e përfshira kanë parashtruar argumentet e tyre para Panelit Shqyrtues. Pas analizimit të provave, PSH ka vendosur që tenderin në fjalë të kthejë në **ri-tenderim**.

Gjithashtu, MFSK-ja ka kthyer në **ri-vlerësim** tenderin “furnizim me inventar për nevojat e FSK-së dhe MFSK-së”. Kjo për shkakun se ka bërë shkelje të nenit 28 dhe të nenit 7 të LPP-së, duke qenë se në specifikacionet teknike është favorizuar prodhimi i automjeteve ‘Volksäagen’. Gjatë këtij intervali kohor MFSK ka bërë shkelje ligjore edhe në tenderin “Furnizim me cizme ushtarake për nevojat e FSK-së”. Në këtë tender MFSK-ja ka bërë shkelje të nenit 51, 59 dhe 109.2, me ç’rast ky tender është kthyer në **ri-vlerësim**.

Ministria e Shëndetësisë

Ministria e Shëndetësisë ka bërë shkelje të shumta ligjore në dy aktivitete të ndryshme të prokurimi. Shkeljet e para janë konstatuar në tenderin “furnizim me barna dhe material medicinal shpenzues nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë”. Fillimisht, kompania “Redoni HM” ishte ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Më pastaj, OSHP ka caktuar ekspertin shqyrtues për ta analizuar procesin e këtij aktiviteti të prokurimi, i cili nuk kishte konstatuar ndonjë shkelje të autoritetit kontraktues në këtë tender. Mirëpo, Paneli Shqyrtues, pas analizimit të provave të operatorit ankues, pretendimeve të autoritetit kontraktues, ekspertizës së ekspertit shqyrtues, ka nxjerrë vendim që këtë aktivitet të prokurimit të kthejë në **ri-tenderim** për shkak se gjatë këtij aktiviteti nuk ishin respektuar neni 10 (Mjetet për promovimin e Transparencës) dhe neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).³⁰

Ndërkaq, parregullsitë e tjera ligjore kanë ndodhur në tenderin “furnizim me Citostatik-Ritender Lot 6”. Fillimisht, kompania “Redoni HM” ishte ankuar në OSHP për parregullsi në këtë tender, sepse operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka poseduar autorizim nga

²⁸ Me gjerësisht shih vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik: http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/studim_shpernd_shtat11.pdf

²⁹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/studim_shpernd_shtat11.pdf

³⁰ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/furnz_barna_msh_korrik11.pdf

prodhuesi, pasi që “Imatinib Mesylate” është produkt i patentuar dhe i vetmi prodhues që ka të drejtë ta prodhojë është “Novartis” nga Zvicra. Më pastaj, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka caktuar ekspertin shqyrtues, i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se AK nuk ka bërë shkelje dhe ankesat e OE të shpallën të pabazuara. Mirëpo, me konstatimet e ekspertit nuk është pajtuar kompania ankuese, me ç’rast është organizuar edhe një seancë dëgjimore. Bazuar në provat e operatorit ekonomik, kompania fituese “RIMED” është shpërblyer me kontratë me autorizim nga prodhuesi “FARMAKOS, i cili nuk e prodhon këtë produkt, por vetëm e importon. Ndërkaq, pretendimet e autoritetit kontraktues dhe ekspertit shqyrtues sipas OSHP-së kanë qenë të pabazuara dhe më këtë rast ka vendosur që tenderin në fjalë ta kthejë në ri-vlerësim.³¹

Duke parë që Ministria e Shëndetësisë nuk po e respekton këtë vendim përfundimtar, OSHP-ja ka lëshuar një urdhëresë në adresë të kësaj ministrie, ku kërkohet të zbatohet në mënyrë të menjëhershme vendimi për ri-vlerësim. Në të kundërtën, OSHP-ja ka kërcënuar se do ta gjobisë në vlerë prej 5,000.00 euro, ndërkaq ndaj menaxherit të prokurimit do të ndërmerren masa disiplinore - në përputhje me Ligjin mbi Shërbyesit Civilë.³² Pasi që Ministria e Shëndetësisë nuk e ka zbatuar një vendim të tillë, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik e ka gjobitur këtë ministri me 30,000.00 euro dhe ka kërkuar të ndërmerren masa ndëshkimore ndaj zyrtarit kryesor të prokurimit.

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka refuzuar njashtu kërkesën e MSH-së për revokim të nenit 30 të Ligjit mbi Prokurimin Publik lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me barna dhe material shpenzues nga lista esenciale”.³³ Eksperti shqyrtues në raportin e tij ka konstatuar se parimi themelor i barazisë në trajtim/jo diskriminim nuk është respektuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Me këtë rast Agjencioni i Prokurimit Publik ka marrë vendim mbi refuzimin e kërkesës së MSH-së me arsyetimin se në dosjen e tenderit nuk janë kërkuar mostrat ose katalogët, duke mos u dhënë kështu kohë të mjaftueshme operatorëve ekonomikë për t’i sjellë ato. Andaj, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se MSH nuk e ka respektuar nenin 6.6 të LPP-së, ku në mënyrë taksative nënvizohet se asnjë kërkesë, kriter apo specifikim që nuk është kërkuar në njoftimin për kontrata dhe në dosjen e tenderit nuk mund të përdoret në procesin e përzgjedhjes ose të dhënies së kontratave.³⁴ Përveç këtij lëshimi, zyrtari i prokurimit, Ekrem Maliqi, përmes një parashtrere e ka njoftuar OSHP-në lidhur me ankesën e parashtruar në Komisionin për Ankesa në MSH. Sipas këtij zyrtari Sekretari i Përhershëm (SP) i kësaj ministrie, Ilir Tolaj, ka bërë presion tek ky zyrtar për të arritur interesat e tij personale rreth këtij tenderi.³⁵

Shkeljet ligjore të ministrive në një tender

Ministria e Financave - ka bërë shkelje të shumta gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit për tenderin “Shërbimet bankare, kartelat debit, kartelat kredit dhe shërbime të llogarisë rrjedhëse për ambasadat e huaja dhe shërbime të kartelave të kreditimit për qeverinë e Kosovës”. Pasi operatori ekonomik “Banka Ekonomike” nga Prishtina ishte

³¹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/furnz_citos_shtat11.pdf

³² http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/urdh_furnz_citostatik_shtat11.pdf

³³ Po aty, Nr. 13/11, 28 Shkurt, 2011, fq.1

³⁴ Po aty, fq. 2


³⁵ Po aty, Nr. 09/2011, 24 qershor, 2011

ankuar për parregullsi të shumta ligjore me rastin e këtij aktiviteti të prokurimit, OSHP-ja ka caktuar ekspertin shqyrtues për të parë nëse ka pasur apo jo shkelje. Sipas tij autoriteti kontraktues nuk ka respektuar zbatimin e procedurave të prokurimit duke shkelur nenin 9 (Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur), nenin 27 (Dosja e tenderit) nuk është përgatitur sipas shërbimeve të kërkuara, neni 28 (Specifikimet teknike) dhe nenin 62 (Përfundimi i aktivitetit të prokurimit). Më pastaj Paneli Shqyrtues e ka informuar Ministrinë e Financave për shkeljet e tilla dhe kjo e fundit është pajtuar që këtë aktivitet të prokurimit të anulohet në tërësi - **ri-tenderim**.³⁶

Ministria e Punëve të Brendshme - ka bërë shkelje ligjore në aktivitetin e prokurimit “furnizim me tonerë”. Kompanitë “Europrinty” dhe “Aerocom” nga Prishtina ishin ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik për parregullsi të shumta që e kanë shoqëruar një tender të tillë. Më pastaj, OSHP-ja e ka caktuar ekspertin shqyrtues, i cili nuk kishte konstatuar ndonjë shkelje gjatë procesit të vlerësimit të ofertave - siç kanë pretenduar kompanitë ankues. Megjithatë, Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues, konstatimeve të ekspertit, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesve të ankesës, ka konstatuar se MPB ka bërë shkelje të nenit 58 (Hapja e Tenderëve) dhe 32 (Rregullat e Përgjithshme) të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Me këtë rast është vendosur që tenderi në fjalë të kthehet në **ri-tenderim**.

Ministria e Diasporës - ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Furnizim me automjete për nevoja të Ministrisë së Diasporës - 3 lote”, me ç’rast është kthyer në **ri-tenderim**. Kjo për shkakun se Ministria e Diasporës ka vendosur specifitime preferenciale të llojit të

veturave, gjë që është e ndaluar me dispozitat ligjore të Ligjit mbi Prokurimin Publik.



Shkeljet e Ndërmarrjeve Publike

Ndërmarrjet publike kanë bërë shkelje të shumta ligjore në nëntë (9) tenderë të ndryshëm. Korporata Energjetike e Kosovës

ka bërë shkelje në gjashtë (6) tenderë, ndërkaq Postë-Telekomi i Kosovës ka bërë shkelje ligjore në tre (3) aktivitete të ndryshme të prokurimit. Prej tyre 3 kanë shkuar në ri-tenderim, një nuk është lejuar të anulohet dhe pesë tenderë të tjerë në ri-vlerësim. Gjatë muajit janar OSHP-ja ka nxjerrë edhe një vendim ndëshkues financiar për PTK-në në vlerë prej 20.000.00 Euro dhe 2000.00 Euro për Menaxherin e Prokurimit. Ky vendim është aprovuar për shkak se PTK-ja nuk ka respektuar vendimin dhe urdhëresën e OSHP-së në

³⁶ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Sherb_bank_Amba_Hua_%20Qever_Kos.pdf

lidhje me tenderin e vitit të kaluar (2010) “furnizime me hardware, software dhe pajisje përcjellëse teknologjike për Automatizimin e Sporteleve të Postës së Kosovës”.

Korporata Energjetike e Kosovës

KEK ka bërë shkelje ligjore në gjashtë (6) tenderë të ndryshëm. Shkelja e parë është bërë lidhur me tenderin “Auditimi i pasqyrave financiare të KEK-ut për periudhën VF 2010”³⁷, ndërkaq ajo e dyta është bërë në tenderin “furnizim dhe liferim të njehsorëve të energjisë elektrike për konsumatorët shtëpiak”.³⁸ Në rastin e parë KEK-u nuk ka respektuar Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, sepse operatori ekonomik “Grant Thornton” ka qenë i angazhuar si auditor i jashtëm për KEK-un për vitet 2005, 2006 dhe 2007. Bazuar në këtë ligj ndërmarrjet publike nuk kanë të drejtë t’ua japin tenderët kompanive që më herët kanë qenë të angazhuar për tri vite - deri në një periudhë gjashtë vjeçare. Duke parë këtë shkelje OSHP-ja ka vendosur që tenderin e tillë ta anulojë - konform konstatimeve të ekspertit shqyrtues. Në rastin e dytë PSH, bazuar edhe në të gjeturat e ekspertit shqyrtues, ka konstatuar se KEK-u gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar nenin 30 A.4 të LPP-së, duke qenë se në këtë aktivitetet të prokurimit asnjë operator ekonomik nuk ka qenë i përgjegjshëm. Më pastaj OSHP-ja ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-tenderim.

Shkelja e tretë është bërë lidhur me tenderin “Furnizim me filtra elektrikë për blloqet A3, A4 dhe A5 në TC Kosova A -përfshirë projektimin, rikonstruktimin dhe implementimin konform kërkesave të standardeve LCPD (2001/80/EC) për emisione të koncentrimin të pluhurit në atmosferë 50 mg/nm³-pjesa 1 dhe pjesa 2”.³⁹ Ndërkaq, shkelja e katërt është bërë në aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe liferimi i njësorëve elektrikë për KEK”. Në rastin e tenderit të tretë eksperti shqyrtues ka konstatuar se KEK-u nuk ka respektuar nenin 34.4 (Procedurat e negociuara pas publikimit të njoftimit të kontratës). Në këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues kishte kërkuar sqarime shtesë vetëm nga operatorët “Hamon Enviromental GmbH & Interling GmbH” dhe PB & EKTEN D.O.O. & Prima Commerce”, por jo edhe nga kompania (ankuese) “VEC” nga Kroacia. Duke parë këtë shkelje eksperti shqyrtues ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues duhet të kërkojë sqarime shtesë edhe nga operatori ekonomik “VEC” dhe në këtë mënyrë të vazhdojë me procedurat e mëtejme sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik.⁴⁰ Me këtë mendim të ekspertit është pajtuar edhe KEK-u. Ndërkaq, në aktivitetin e katër të prokurimit KEK-u nuk ka zbatuar dispozitat ligjore me rastin e vlerësimit të ofertave, duke bërë shkelje të neneve 7 (Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi dhe Transparenca), 28 (Specifikimet teknike) dhe 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).⁴¹ Ky tender është kthyer në ri-vlerësim.

Shkelja e radhës është bërë në aktivitetin e prokurimit “furnizim dhe liferim i njehsorëve elektrikë për konsumatorët shtëpiak”. Në këtë tender KEK-u ka bërë shkelje të shumta

³⁷ Vendimi i OSHP-sw, Nr. 559/10, 14 Janar, 2011, fq. 2

³⁸ Po aty, Nr. 579/10, 19 Janar, 2011, fq. 1-2

³⁹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Fur_Filtra_TC-Kos_A.pdf

⁴⁰ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Fur_Filtra_TC-Kos_A.pdf


⁴¹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/furnz_liferimi_kek_qersh11.pdf

ligjore, ku më pastaj operatori ekonomik “Sagecom Energy&Telecom S.A.S.” nga Franca është ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Më pastaj, eksperti shqyrtues ka konstatuar se KEK-u nuk ka bërë asnjë shkelje gjatë këtij aktiviteti të prokurimit. Mirëpo, pas refuzimit të kësaj ekspertize nga ana e operatorit ekonomik, si dhe dëgjimit të provave në seancën dëgjimore, Paneli Shqyrtues ka konstatuar shkelje të nenit 10 (Mjetet për promovimin e Transparencës), 29 (Variantet e specifikimeve teknike), 53 (Sigurimi i Informatave Shtesë për Kandidatët dhe Tenderuesit) dhe 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të LPP. Me këtë rast është vendosur që ky aktivitet prokurimi të kthehet në **ri-tenderim**.

Shkeljet e radhës ligjore kanë ndodhur në tenderin tjetër “Furnizim me shkarkues të mbitensionit”. Në këtë tender KEK nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomikë, me ç’rast ka favorizuar kompaninë “Ukab” dhe ka diskriminuar kompaninë ankuese “Elmonti”. Duke marrë parasysh këto parregullsi, OSHP-ja ka vendosur që këtë aktivitet prokurimi ta kthejë në **ri-vlerësim**.

Shkelja tjetër ligjore ka ndodhur me rastin e tenderit “Fushata edukuese, sensibilizuese për publikun”. Në këtë tender KEK ka diskriminuar operatorin ekonomik ankues “N.SH.2B”, ndërkaq ka favorizuar kompaninë “New Film & the Group” nga Prishtina. Në njoftimin e autoritetit kontraktues është njoftuar se asaj i është dhënë kontrata, ani pse nuk ka përmbushur kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit. Disa nga to janë mos-ofrimi i dëshmimeve për kualifikimet e punëtorëve të kësaj kompanie, pastaj ka ofruar vetëm një referencë në vlerë prej 250,000.00 euro, ndërkaq është dashur të jenë dy të tilla, etj. Kështu që, duke parë këto parregullsi OSHP-ja ka vendosur që këtë aktivitet prokurimi ta kthejë në **ri-vlerësim**.

Më pas, në vend që KEK të bëjë ri-vlerësimin e këtij tenderi ai e ka bërë anulimin e tij. Duke parë një shkelje të tillë, kompania që i është dhënë tenderi në herën e parë “New Film & the Group” ka parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik, ku ky



i fundit ka **anuluar** vendimin e KEK-ut për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Post-Telekomi i Kosovës

PTK ka bërë shkelje të mëdha ligjore në tre (3) tenderë të ndryshëm. Në aktivitetin e prokurimit “ndërtimi i rrjetit optik në lagjen Dardania në Prizren - Faza e II”

eksperti shqyrtues ka konstatuar se PTK-ja ka bërë shkelje të shumta ligjore: neni 27 (dosja e tenderit), neni 57 (sigurimi i tenderit), neni 59 (ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve), neni 60 (kriteret për dhënien e kontratës), neni 66

(përshtatshmëria profesionale)⁴² dhe shkelje të dispozitave të nenit 29.15 të Rregullores së Prokurimit Publik - pjesa B.⁴³ Edhe pse AK e ka specifikuar se kontrata do t'i jepet operatorit ekonomik që është me çmim më të lirë, ajo i është thënë kompanisë me çmim më të lartë për 9.438.59 Euro diferencë. Më pastaj Organi Shqyrtues i Prokurimit ka vendosur që këtë tender ta kthejë në ri-tenderim. Ndërkaq, gjatë muajit janar OSHP-ja ka nxjerrë edhe një vendim ndëshkues financiar për PTK-në në vlerë prej 20.000.00 Euro dhe 2000.00 Euro tjera për Menaxherin e Prokurimit. Ky vendim është aprovuar për shkak se PTK-ja nuk ka respektuar vendimin dhe urdhëresën e OSHP-së në lidhje me tenderin e vitit të kaluar (2010) “furnizime me hardëare, softëare dhe pajisje përcjellëse teknologjike për Automatizimin e Sporteleve të Postës së Kosovës”. Sipas OSHP-së PTK-ja pa të drejtë kishte eliminuar operatorin ekonomik “DataProgNet”. Për këtë arsye ky tender është dashur të kthehet në ri-vlerësim. Mirëpo, PTK-ja e kishte refuzuar një gjë të tillë dhe më pastaj OSHP-ja ka lëshuar një urdhëresë për përmbarrim të vendimit të saj për ri-vlerësim. Duke parë që edhe më tutje PTK-ja ka neglizhuar krejtësisht vendimet e saj, OSHP-ja ka marrë vendim që ta gjobisë PTK-në vlerë prej **20.000.00 Euro**, ndërkaq Menaxherin e Prokurimit me **2,000.00 Euro**.⁴⁴

PTK ka bërë shkelje edhe në tenderin “furnizim me server, SAN, zgjerim dhe mirëmbajtje të SAN-it ekzistues”.⁴⁵ Fillimisht, ofertuesi “PBC - Kosova” nga Prishtina është ankuar kundër njoftimit të PTK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit. Komisioni Vlerësues në raportin e vlerësimit e ka arsyetuar rekomandimin e vet për anulimin, duke theksuar se asnjëri nga 4 operatorët ekonomikë për Lot 1 dhe 2 ofertuesit për Lot 2 nuk i kanë autorizimet origjinale sipas formës së dosjes së tenderit, si dhe nuk e posedojnë deklaratën për përputhshmërinë e specifikacioneve teknike për mallrat e ofruara. Mirëpo, eksperti shqyrtues ka konstatuar se PTK gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-së, ndërsa pretendimet e palës ankimore të operatorit ekonomik i cilëson të bazuara. Përveç kësaj, eksperti shqyrtues i është drejtuar në mënyrë elektronike edhe kompanisë austriake “HEËLETT PACKARD” për ta vërtetuar nëse kjo kompani iu ka lëshuar autorizime dy operatorëve ekonomikë “PBC-Kosova” dhe “ASSECO SEE-SHPK” nga Kosova dhe “NEOCOM” nga Maqedonia. Me këtë rast, kompania “HEËLETT PACKARD” e ka konfirmuar se të tre operatorët ekonomikë kanë qenë të autorizuar nga ajo. Më tutje, eksperti ka pohuar se edhe deklarata e përputhshmërisë së specifikacioneve teknike për mallrat e ofruara është e plotësuar konform dosjes së tenderit, kështu që për LOT 1 konstaton se tre operatorë ekonomikë i plotësojnë kriteret, ndërkaq për LOT 2 vetëm dy ofertues i plotësojnë kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktues. Megjithatë, PTK-ja nuk është pajtuar me mendimin e ekspertit, me ç'rast është thirrur një seancë dëgjimore. Pas mbledhjes së fakteve dhe provave, Paneli Shqyrtues ka vendosur në favor të kompanisë ankues dhe analizës së ekspertit shqyrtues. Andaj, ky tender është kthyer në **ri-vlerësim**.

⁴² Po aty, Nr. 16/11, 11 Mars, 2011, fq. 1-2

⁴³ Rregullora e Prokurimit Publik

⁴⁴ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Nr. 317/10, 480/10, 13 Janar, 2011, fq. 1-3

⁴⁵ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/furnz_serv_san_shtat11.pdf

Shkeljet nga ana e Komunave

Komunat gjatë vitit 2011 kanë bërë shkelje të shumta ligjore në gjithsej 37 aktivitete prokurimi. Prej tyre njëzetekatër (24) janë kthyer në ri-vlerësim, 11 në ri-tenderim dhe vetëm 2 nuk janë lejuar të anulohen nga autoritetet kontraktuese. Komunat më me shumë shkelje janë Komuna e Lipjanit dhe ajo e Suharekës, me nga katër (4) tenderë. Pastaj vijnë komuna e Prishtinës, e Gjilanit, e Rahovecit dhe ajo e Vitisë me nga tre (3) tenderë. Ndërkaq, me nga dy (2) tenderë janë Komuna e Graçanicës, e Podujevës, e Shtërpçës dhe ajo e Kamenicës. Dhe me nga një tender të vetëm janë Komuna e Pejsës, e Ferizajt, e Prizrenit, e Kaçanikut, e Istogut, e Klokotit, e Fushë Kosovës, e Mitrovicës dhe ajo e Klinës.

Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit ka bërë shkelje ligjore në katër tenderë të ndryshëm. Në fillim të vitit 2011 OSHP-ja ka anuluar vendimin e kësaj komune për anulim të tenderit “Ndërtimi i objektit në fshatin Kraishtë”. Pasi që kompanitë “Alber” dhe “Te Muhameti” ishin ankuar në OSHP, kjo e fundit e ka autorizuar ekspertin shqyrtues, i cili pas shqyrtimit të kësaj lëndë ka konstatuar se AK me rastin e anulimit të tenderit të lartpërmendur nuk ka respektuar nenin 62 (Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit) dhe 109 (Afatet për Dorëzimin e Ankesës) të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Në vend që AK të respektojë afatin kohor prej 10 ditësh për ankesa të mundshme me rastin e anulimit, ajo në ditën e anulimit e ka bërë njëkohësisht njoftimin për kontratë. Prandaj, me këtë rast Paneli Shqyrtues e ka anuluar vendimin e AK për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Përgjatë kësaj periudhe kohore ka bërë shkelje të shumta edhe në tre tenderë të ndryshëm. Në tenderin e parë “meremetimi i objektit të shkollës fillore “Zenel Hajdini në Gadime” ka bërë shkelje të nenit 52⁴⁶ dhe 54⁴⁷ të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Fillimisht, kompania “Te Muhameti” ishte ankuar në OSHP, me ç’rast është caktuar edhe eksperti shqyrtues për analizimin e kësaj lëndë. Sipas raportit të ekspertit është konstatuar se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore me rastin e vlerësimit të ofertave. Megjithatë, Komuna e Lipjanit nuk është pajtuar me rekomandimin e ekspertit për ta kthyer tenderin në fjalë në ri-vlerësim. Me këtë rast OSHP-ja ka caktuar një seancë dëgjimore, ku edhe janë vërtetuar shkeljet e konstatuar nga eksperti shqyrtues. Bazuar në të gjeturat e konstatuar, Paneli Shqyrtues ka nxjerrë vendimin për ri-vlerësim të këtij aktiviteti të prokurimit. Përveç kësaj, Komuna e Lipjanit ka bërë shkelje edhe në tenderin tjetër “meremetimi i objektit të QKMF-së”. Pas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Euro-Service” nga Prishtina, OSHP-ja e caktuar ekspertin e saj shqyrtues. Bazuar që autoritetit kontraktues i ka munguar komplet dosja e tenderit, eksperti ka rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim. Mirëpo, komuna nuk është pajtuar me një vlerësim të tillë. Më pastaj, është organizuar një seancë dëgjimore, ku palët e përfshira në këtë kontest kanë ofruar argumentet e tyre. Me këtë rast, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK nuk ka respektuar nenin 10 të LPP-së dhe për rrjedhojë tenderi në fjalë duhet të kthehet në ri-vlerësim.

⁴⁶ Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës, Ligji i Prokurimit Publik, Nr. 03/L-241, fq. 55

⁴⁷ Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar, Ligji i Prokurimit Publik, Nr. 03/L-241, fq. 57

Gjithashtu, Komuna e Lipjanit ka bërë shkelje edhe në tenderin tjetër “rregullimi i kanalizimit fekale në Sllovi - faza e II-të”. Pasi që kompania “Muratori” ishte ankuar për parregullsi të shumta që e kanë shoqëruar tenderin në fjalë, OSHP-ja ka caktuar ekspertin shqyrtues. Sipas raportit të ekspertit Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në bazë të dispozitave ligjore, duke bërë shkelje të shumta ligjore. Me këtë rast, eksperti ka rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **ri-vlerësim**, gjë që Paneli Shqyrtues është pajtuar në tërësi me ekspertizën e tillë dhe ka nxjerrë vendimin konform kërkesave të ekspertit dhe ankesave të operatorit ekonomik.

Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës ka bërë shkelje të shumta në katër aktivitete të ndryshme prokurimi. Fillimisht ka bërë shkelje në procesin tenderues “ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Grejkoc”. Pas njoftimit për dhënie të kontratës, kompania “Qami Rrezon” është ankuar tek OSHP-ja, duke pretenduar së AK qëllimisht e ka përzgjedhur “Berisha Company” si fitues të këtij tenderi, ani pse me një çmim prej 7.200.00 Euro më të lartë. Pas mbledhjes së fakteve, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se AK ka bërë shkelje të nenit 50.2, 50.3 dhe 58.2 të LPP-së gjatë dhënies së këtij tenderi. Me këtë rast PSH e ka kthyer këtë tender në **ri-tenderim**.

Komuna e Suharekës ka bërë shkelje ligjore edhe me rastin e dhënies së tenderit “ndërtimi i shtëpisë së pleqve në fshatin Gjinovc - Komuna e Suharekës”. Fillimisht kompania “Maloku” ishte ankuar për shkelje gjatë këtij aktiviteti të prokurimit dhe më pastaj eksperti shqyrtues ka konstatuar shkelje të mëdha. Duke parë parregullsitë që kishin shoqëruar këtë tender, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka marrë vendim që ta kthejë në **ri-vlerësim**. Ky vendim ka qenë si rezultat se komisioni vlerësues ka eliminuar padrejtësisht kompaninë në fjalë - për faktin se ky operator ekonomik ka tenderuar si grup i operatorëve ekonomikë me OE “Iliri”, i cili ka ofruar si dëshmi të gjitha dokumentet që janë kërkuar: përshtatshmërinë, certifikatën e biznesit, certifikatën me numër fiskal, certifikatën e regjistrimit të TVSH-së, licencë ndërtimi, deklaratën nën betim, vërtetimin e Gjykatës Ekonomike, vërtetimin e ATK-së, si dhe vërtetimin për pagesën e obligimeve komunale - ashtu siç kërkohet me nenin 71.4 të LPP-së.

Gjithashtu, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka kthyer në **ri-vlerësim** edhe tenderin “Mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve të QKMF-ve dhe meremetimi i ambulancave në Dobërdolan dhe Samadraxhë”. Pas ankesës së “Agrolmpex” dhe caktimit të ekspertit shqyrtues për analizimin e kësaj lënde ishte konstatuar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 49.1 dhe 50.1 të LPP-së, me ç’rast ky aktivitet i prokurimit është kthyer në **ri-vlerësim**.

Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës ka bërë shkelje ligjore në tre (3) tenderë të ndryshëm. Shkelja e parë është bërë në tenderin “Pastrimi i objektit të shkollës së gjelbër dhe anekseve të shkollave fillore “Naim Frashëri” dhe “Dardania”.⁴⁸ Fillimisht kompania “MSS-Mobile Sanitary Service” është ankuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ku ky i fundit ka

⁴⁸ Nr. i Prokurimit 616/11/001/221, Komuna e Prishtinës, 28 mars, 2011.

aprovuar ankesën e këtij OE si të bazuar. Më pastaj Komuna e Prishtinës dhe kompania në fjalë kanë ofruar argumentet e tyre pranë Panelit Shqyrtues të OSHP-së, ku ky i fundit ka vendosur që tenderin në fjalë ta kthejë në **ri-vlerësim**, pasi që gjatë procesit të vlerësimit në këtë aktivitet të prokurimit nuk janë respektuar nenet 57 dhe 58 të LPP-së.⁴⁹

Komuna e Prishtinës ka bërë shkelje edhe me rastin e aktivitetit të prokurimit “Furnizim me material zyrtar për nevojat e Komunës”. Pas ankesës së operatorëve ekonomikë “NTG Blendi” dhe “NTGT Grafo Trade” ekspertit shqyrtues ka konstatuar se ankesat e tyre janë të bazuara, meqë Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në tërësi kriterin e vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit të ofertave - shikuar nga aspekti i lartësisë së çmimeve për pjesët 2, 3 dhe 4. Mirëpo, ndonëse Komuna e Prishtinës nuk ishte pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, OSHP-ja pas dëgjimit të argumenteve në seancën dëgjimore ka konstatuar se komuna ka shkelur nenet 10 (Mjetet për promovimin e Transparencës) dhe 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës). Me këtë rast Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka vendosur që tenderin në fjalë të kthejë në **ri-vlerësim**.⁵⁰

Gjithashtu, komuna e Prishtinës ka bërë shkelje lidhur me aktivitetin e prokurimit “furnizim dhe montim të semaforëve në tri nyejt semaforike në Prishtinë”. Pas ankesës së operatorit ekonomik “Road Sings & Marketing” ekspertit shqyrtues ka konstatuar se ankesa e tillë është e bazuara, meqë Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në tërësi kriterin e vlerësimit gjatë procesit të vlerësimit të ofertave - duke shkelur nenin 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Mirëpo, ndonëse Komuna e Prishtinës nuk ishte pajtuar me mendimin e ekspertit shqyrtues, OSHP-ja pas dëgjimit të argumenteve në seancën dëgjimore ka konstatuar se komuna ka shkelur nenet 32 (Rregullat e Përgjithshme) dhe 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të LPP-së, me ç’rast këtë aktivitet të prokurimit e ka kthyer në **ri-tenderim**.

Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka bërë shkelje të shumta ligjore në tre aktivitete prokurimi. Fillimisht ka bërë shkelje të shumta në tenderin “Mirëmbajtja e ndriçimit publik”. Në këtë tender sipas ekspertit shqyrtues janë shkelur nenet 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca), 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës), 66 (Përshtatshmëria Profesionale) dhe 71 (Grupet e Operatorëve Ekonomik dhe Operatorët e Huaj Ekonomik). Me këtë mendim të ekspertit janë pajtuar edhe Autoriteti Kontraktues edhe operatori ankues ekonomik “Termomontimi”. Me këtë rast OSHP-ja ka marrë vendim që aktivitetin e prokurimit në fjalë të kthejë në **ri-vlerësim**, duke qenë se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk janë respektuar procedurat dhe dispozitat e prokurimit publik.

Ky autoritet kontraktues a bërë shkelje të shumta me rastin e anulimit të tenderit “rregullimi i shtratit të lumit BAJA”. Ky tender sipas ekspertit shqyrtues është anuluar me të drejtë nga Komuna e Gjilanit - për shkak të ndryshimeve që janë menduar të bëhen në projekt nga kryetari i Komunës. Megjithatë, gjatë shqyrtimit të fakteve në dosjen e tenderit dhe rrjedhën e procesit deri në anulim nga AK, Paneli Shqyrtues ka nxjerrë vendim për anulim të tenderit të anuluar nga Komuna e Gjilanit. Më tutje, OSHP-ja ka

⁴⁹ Nr. 26/11, Organi Shqyrtues i Prokurimit, 30 mars, 2011, fq. 1-2

⁵⁰ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Fur_mat_Zyr_Komu.pdf

kërkuar që tenderi në fjalë të aktivizohet menjëherë dhe në asnjë mënyrë të mos anulohet. Gjithashtu, Komuna e Gjilanit ka bërë shkelje edhe në tenderin tjetër “Fasadimi i objekteve kolektive në lagjen Iliria”. Sipas ekspertit shqyrtues kompania ankuese “ENGROUP - SHPK” është eliminuar padrejtësisht nga ky aktivitet i prokurimit, me ç’rast autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve), 64 (Dëshmitë e Kërkesave) dhe 65 (Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve) të Ligjit mbi Prokurimin Publik. Me këtë rast, eksperti shqyrtues ka rekomanduar që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **ri-vlerësim**, meqë kompania ankuese, e cila është eliminuar për mungesë të vërtetimit nga Administrata Tatimore e Kosovës, e posedon një vërtetim të tillë dhe ankesat e saj janë të bazuara. Me këtë vlerësim të ekspertit është pajtuar edhe Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjilanit.

Kjo komunë ka bërë shkelje ligjore në tremujorin e fundit edhe në dy tenderë të ndryshëm. Shkeljet e para janë paraqitur në tenderin “Furnizim me material për zyre, tonerë dhe material botues - i ndarë në tri lote”. Në këtë tender janë shkelur nenet 1, 6, 7, 52 dhe 59 të LPP-së, me ç’rast PSH ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-tenderim**. Gjithashtu, edhe në tenderin “Sigurimi fizik i objekteve të KK - Gjilan” kjo komunë ka bërë shkelje ligjore, pasi që ka shpërblyer kompaninë “SAS” - që nuk ka plotësuar kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktues. Kështu që, ky tender është kthyer në **ri-vlerësim** nga ana e OSHP-së.

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka bërë shkelje të shumta në tre aktivitete të prokurimit. Shkeljet e para kanë qenë në aktivitetin e prokurimit “vendosja e ngrohjes qendrore në shkollën fillore “Isa Boletini” në Rahovec”. Ndonëse eksperti shqyrtues nuk ka konstatuar ndonjë shkelje në raportin e tij, Paneli Shqyrtues ka vërtetuar se në këtë aktivitet të prokurimit është shkelur neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve). Andaj, PSH ka vendosur që ta kthejë në **ri-vlerësim** këtë tender. Përveç shkeljeve në këtë tender, Komuna e Rahovec ka bërë edhe shkelje tjera në tenderin “blerja e dy automjeteve për Komunën e Rahovecit”. Në këtë aktivitet të prokurimit 3 operatorë ekonomikë janë shpallur të përgjegjshëm, ndërkaq operatori i rekomanduar për kontratë ka qenë “Autosalloni Morina”. Mirëpo, kompania “AGS” është ankuar në OSHP për parregullsi ligjore, gjë që edhe eksperti shqyrtues ka konstatuar se në këtë aktivitet të prokurimit është shkelur neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) i Ligji mbi Prokurimin Publik. Ndërkaq, pas dëgjimit të provave në seancën dëgjimore, OSHP-ja ka konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar në tërësi specifikat teknike sipas dosjes së tenderit dhe për pasojë operatori i tillë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Me këtë rast, OSHP-ja ka kërkuar që tenderi në fjalë të kthehet në **ri-vlerësim**.

Përveç shkeljeve në këta dy tenderë, Komuna e Rahovecit ka bërë shkelje edhe në një tender tjetër: “Ndërtimi i Shkollës Fillore në Malësi të Vogël”. Fillimisht, kompania “Coneng” nga Prizreni ishte ankuar në OSHP, ku kjo e fundit e ka caktuar edhe ekspertin shqyrtues për t’i analizuar pretendimet e kompanisë në fjalë. Në ekspertizën e tij eksperti ka konstatuar se autoriteti kontraktues ka respektuar dispozitat në fuqi të LPP-së, por me

një mendim të tillë nuk është pajtuar edhe Paneli Shqyrtues, i cili këtë aktivitet prokurimi e ka kthyer në **ri-tenderim**.

Komuna e Vitisë

Komuna e Vitisë ka bërë shkelje me rastin e tenderit “furnizim me material të shtypur, reklamues dhe rekuizita sportive për nevojat e administratës komunale dhe drejtorisë për arsim - Viti”. Organi Shqyrtues pas pranimit të ankesës nga operatori ekonomik “Studio Grafik - Visual Media +” DPT “Albi” ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të këtij prokurimi, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës, me ç’rast ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka vendosur që tenderin në fjalë ta kthejë në **ri-vlerësim** për shkak se AK ka bërë shkelje të nenit 54 (Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar) dhe atij 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).

Gjithashtu, komuna e Vitisë ka bërë shkelje ligjore edhe në tenderin “Rregullimi i murit mbrojtës në shkollën fillore Hasan Alia në fshatin Remnik”. Ky aktivitet prokurimi është vendosur të kthehet në **ri-vlerësim**, pasi që ky autoritet kontraktues nuk ka përfillur dispozitat e nenit 59 të LPP-së, duke qenë se ka përjashtuar pa të drejtë njërin nga operatorët ekonomikë ofertues. Pasi që ky tender është ri-vlerësuar sërish nga ana e komunës së Vitisë është anuluar në tërësi - si rrjedhojë që vetëm një ofertues ka qenë i përgjegjshëm. Mirëpo, në herën e parë komuna e Vitisë kishte shpallur dy tenderë të përgjegjshëm dhe jo vetëm një siç ka deklaruar më vonë. Kjo ka bërë që ndaj kësaj komune OSHP-ja të shqiptojë gjobën në vlerën prej 10,000.00 euro dhe të **anulojë** vendimin për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit.

Komuna e Graçanicës

Ka bërë shkelje të dispozitave ligjore në tenderin “furnizim dhe montim me pajisje për monitorim të rrugëve të Graçanicës”. Në këtë tenderë kanë ofertuar gjithsej 9 (nëntë) operatorë ekonomikë, ku njëra prej tyre është cilësuar si e papërgjegjshme. Pas njoftimit për dhënie të kontratës, 2 (dy) operatorë ekonomikë⁵¹ kanë dorëzuar ankesat e tyre në OSHP për parregullsi të shumta ligjore. Më pastaj Paneli Shqyrtues pranë këtij institucioni ka konstatuar se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave AK ka bërë shkelje të nenit 6⁵² dhe atij 57⁵³ të LPP-së. Me këtë rast Organi Shqyrtues i Prokurimit ka vendosur që tenderin në fjalë ta kthejë në **ri-vlerësim**.

Për shkak të mos zbatimit të vendimit të OSHP-së për ri-vlerësim të tenderit “furnizim dhe montim me pajisje për monitorim të rrugëve të Graçanicës” është ndëshkuar me një dënim në gjobë prej 6,000/00 Eurove. Ky dënim ka ardhur si pasojë së Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar vendimin e mëparshëm të OSHP-së për rivlerësim të këtij tenderi. Në këtë tenderë kishin ofertuar gjithsej 9 (nëntë) operatorë ekonomikë, ku njëra prej tyre ishte cilësuar si e papërgjegjshme. Pas njoftimit për dhënie të kontratës, 2 (dy)

⁵¹ Kompania “Pro 4” dhe “Treo Electronics”

⁵² Neni i Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

⁵³ Neni - Sigurimi i Tenderit

operatorë ekonomike⁵⁴ kishin dorëzuar ankesat e tyre në OSHP për parregullsi të shumta ligjore. Më pastaj Paneli Shqyrtues pranë këtij institucioni kishte konstatuar se gjatë procesit të vlerësimit të ofertave AK ka bërë shkelje të nenit 6⁵⁵ dhe atij 57⁵⁶ të LPP-së. Me këtë rast Organi Shqyrtues i Prokurimit ka vendosur që tenderin në fjalë ta kthejë në **ri-vlerësim**. Kështu që, meqë Komuna e Graçanicës nuk e ka respektuar një vendim të tillë OSHP-ja e ka dënuar me 6,000.00 Euro.

Komuna e Podujevës

Organi Shqyrtues i Prokurimit gjatë muajit janar ka lëshuar një urdhëresë ndaj Komunës së Podujevës për respektim të vendimit mbi “ndërtimin e kanalizimit fekale në fshatin Dumnicë e Poshtme - Lot 1 dhe Lot 2”. Për shkak të parregullsive gjatë procesit të prokurimit OSHP-ja ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**. Mirëpo, Komuna e Podujevës nuk e ka respektuar këtë vendim dhe tenderin në fjalë e ka anuluar krejtësisht. Me këtë rast OSHP-ja ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit nuk është mbështetur në asnjë dispozitë ligjore - siç kërkohet me nenin 50 A të LPP-së. Nëse Komuna e Podujevës nuk e respekton këtë vendim të OSHP-së atëherë do të gjohet mbi 5000.00 Euro dhe ndaj nëpunësit civil (zyrtarit të prokurimit) do të pushohet nga puna dhe do të gjohet po ashtu mbi 1000.00 Euro.⁵⁷

Komuna e Podujevës ka bërë shkelje njëherazi edhe me rastin e tenderit “Furnizim me miell për familjet në gjendje të rëndë sociale”. Organi Shqyrtues pas pranimit të ankesës nga operatori ekonomik DPT “Albi”, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procesin e aktivitetit të këtij prokurimi, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Eksperti shqyrtues në muajin maj ka dorëzuar raportin e ekspertizës, me ç’rast ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka vendosur që tenderin në fjalë të anulohet dhe ta kthejë në **ri-tenderim**.

Komuna e Shtërpcës

Komuna e Shtërpcës ka bërë shkelje ligjore në dy tenderë të ndryshëm. Në tenderin e parë, Operatori ekonomik “Infra Tek” nga Prishtina, si palë e pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës, ka parashtruar ankesë lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin “Përpilimi i projekteve detale sipas kërkesës për Komunën e Shtërpcës”. Sipas ekspertit shqyrtues pretendimet e palës ankimore janë të qëndrueshme dhe të bazuara në ligj, ngase Komuna e Shtërpcës nuk e ka përfillur fare procedurën e nenit 60 - Tenderin për dhënien e kontratës me çmim më të ulët. Megjithatë, arsyetimi i AK ka qenë se oferta e kësaj kompanie ka qenë e ulët jashtë normale, mirëpo që OSHP-ja nuk është pajtuar me këtë vlerësim, pasi që kjo kompani është zotuar se do t’i kryejë shërbimet sipas çmimeve të specifikuara në specifikacion. Me këtë rast OSHP-ja ka nxjerrë vendim për **ri-vlerësim** të këtij tenderi.

⁵⁴ Kompania “Pro 4” dhe “Treo Electronics”

⁵⁵ Neni i Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

⁵⁶ Neni - Sigurimi i Tenderit

⁵⁷ Organi Shqyrtues i Prokurimit, Nr. 528/10, 18 janar, 2011, fq.1

Ky autoritet kontraktues ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Ndërtimi i Palestrës Sportive”. Eksperti shqortues i këtij aktiviteti ka konstatuar se komuna e Shtërpçës nuk ka respektuar nenin 59 dhe 60 të LPP-së, pasi që operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk i plotëson të gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit të AK. Duke parë shkeljet e tilla, eksperti shqyrtues ka rekomanduar që ky tender të kthehet në **ri-vlerësim** dhe me një sugjerim të tillë janë pajtuar edhe AK dhe kompania ankuese “NPN Çlirimi”. Mirëpo, për shkak të ndryshimit të linjave buxhetore nga ana e nivelit qendror, ky aktivitet i prokurimit është anuluar në tërësi.

Komuna e Kamenicës

Komuna e Kamenicës ka bërë shkelje ligjore me rastin e aktivitetit të prokurimit “asfaltimi i rrugëve në fshatrat Muhagjerët e Topanicës dhe Behajt e Rogacicës”. Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik, pas pranimit të ankesës së operatorit ankues “Company Zuka Commerce - SHPK”, ka autorizuar ekspertin shqyrtues. Eksperti në muajin gusht ka dorëzuar raportin e tij, me ç’rast ka konstatuar se Komuna e Kamenicës nuk ka respektuar nenin 59 dhe 112 të LPP-së - me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit. Me këtë rast, eksperti ka rekomanduar që tenderi në fjalë duhet të **ri-tenderohet**. Me një mendim të tillë janë pajtuar Komuna e Kamenicës dhe Operatori Ekonomik, po ashtu.

Komuna e Kamenicës ka shpërfillur LPP-në edhe me rastin e tenderit “Asfaltimi i rrugëve në fshatra - Muhaxherët e Topanicës dhe Behajt e Rogacicës”. Për shkak se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kriteret dhe kërkesat e parashtruara në dosjen e këtij tenderi, duke përfshirë planin dinamik tejet të shkurtër (të pamundshme) të punëve dhe listën e punëtorëve që kanë marrëdhënie pune edhe me kompani tjera, PSH ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**.

Shkeljet ligjore të komunave në një tender

Komuna e Pejës - ka bërë shkelje në aktivitetin e prokurimit “Hartimi i planit rregullativ të një pjesë të B.T. “Kapeshtica” dhe “Sahat Kulla” në Pejë”. Ndonëse në këtë proces tenderimi të gjithë operatorët ekonomikë kanë qenë të papërgjegjshëm, komisioni vlerësues i ka shpallur dy kompani të përgjegjshme, me ç’rast e ka shpallur fitues kompaninë “Vision Project” në konsorcium me “Arketima”. Kjo kompani është shpallur fituese ani pse nuk e ka poseduar tatimin mbi pronë, pastaj vërtetimin e ATK-së e ka pasur të skanuar (ndërkaq është kërkuar origjinali) dhe licencën nga MTI e ka pasur po ashtu kopje (ndërkaq është kërkuar origjinali ose i noterizuar). Duke i parë këto shkelje kompania “Urban Plus” ishte ankuar në OSHP-ja dhe më pastaj ky organ ka konstatuar se më këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 34.4⁵⁸ të LPP-së dhe për pasojë tenderi në fjalë duhet të shkojë në **ri-tenderim**.⁵⁹

Komuna e Ferizajt - ka bërë shkelje të shumta në tenderin “Rregullimi i trotuarit në rrugën “Brahim Ademi” në Ferizaj”. Fillimisht kompania “Kompakt” ishte ankuar për shkelje gjatë këtij aktiviteti të prokurimit dhe më pastaj eksperti shqyrtues ka konstatuar

⁵⁸ “Nëse gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit pranohen më pak se dy (2) tenderë të përgjegjshëm ose, kur është e zbatueshme, kërkesa për pjesëmarrje, autoriteti kontraktues duhet të anulohet aktivitetin e prokurimit”, Ligji i Prokurimit Publik, Nr. 03/L-241, fq. 40.

⁵⁹ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Har_plan_Kapesh_Sah_Peje.pdf

shkelje të mëdha. Duke parë parregullsitë që kishin shoqëruar këtë tender, Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka marrë vendim që ta kthejë në **ri-tenderim**. Ky vendim ka qenë si rezultat se komisioni vlerësues nuk ka respektuar nenin 29 (Rregullorja B e Prokurimit Publik), nenin 35 (Procedurat e negociuara pa publikimin e njoftimit të kontratës), 52 (Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës), 54 (Njoftimi i Kandidatëve dhe Tenderuesve të Eliminuar) dhe 58 (Hapja e Tenderëve) të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Komuna e Prizrenit - ka bërë shkelje në procesin tenderues “Mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara dhe rregullimi i pajisjeve ambientale nëpër oaza dhe sheshe publike”. Komisioni vlerësues i këtij aktiviteti të prokurimit padrejtësisht e kishte shpallur kompaninë “Limit” të papërgjegjshme - me arsyetimin se kjo kompani nuk ofron referenca të natyrës së ngjashme dhe se i mungon vërtetimi nga ATK. Megjithatë, pas vlerësimit të provave dhe dëshmive të ofruara nga kjo kompani, Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit ka konstatuar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje dhe ankesat e operatorit ekonomik janë tërësisht të bazuara dhe të provueshme. Me këtë rast ky organ ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**.⁶⁰

Komuna e Kaçanikut - ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e tenderit “largimi i mbeturinave nga depot ilegale dhe pastrimi i përroskave”. Ndonëse në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar 4 operatorë ekonomikë, vetëm njëri ka qenë i përgjegjshëm. Megjithatë, kjo nuk i ka penguar autoritetit kontraktues që ta rekomandojë për kontratë operatorin e vetëm të përgjegjshëm. Madje, në seancën e organizuar nga OSHP-ja edhe vetë përfaqësuesi i AK e ka vërtetuar një gjë të tillë. Duke parë një shkelje të tillë, Paneli Shqyrtues ka vendosur që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në **ri-tenderim** - duke qenë se nuk ka pasur ofertues të mjaftueshëm të përgjegjshëm.

Komuna e Istogut - ka bërë shkelje në tenderin “furnizim me ushqim, pije dhe higjieno sanitari për kopshte dhe institucione tjera komunale”. Operatori ekonomik “Burimi” nga Prishtina, si palë e pakënaqur me njoftimin e AK për dhënie të kontratës, ka parashtruar ankesë në OSHP. Me këtë rast OSHP-ja ka autorizuar ekspertin shqyrtues, i cili në raportin e tij ka evidentuar shkelje të mëdha të neneve ligjore: nenit 58 (Hapja e Tenderëve), 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) dhe 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës) të LPP-së. Megjithatë, Komuna e Istogut nuk është pajtuar me përfundimet e ekspertit, gjë që më pas është mbajtur një seancë dëgjimore. Në këtë seancë janë prezantuar argumentet e secilit subjekt të përfshirë në këtë kontest, mirëpo Paneli Shqyrtues ka evidentuar se oferta e kompanisë (“Jafa”) së rekomanduar për kontratë ka përmbajtur çmime të cilat nuk janë proporcionale me cmimet e tregut dhe për rrjedhojë do t’i shkaktonte dëm buxhetit të Republikës së Kosovës. Me këtë rast OSHP-ja ka vendosur ta **ri-tenderojë** këtë aktivitet të prokurimit për të katërtën herë.

Komuna e Klllokotit - ka bërë shkelje në procesin tenderues “asfaltimi i rrugëve në Klllokot”. Operatori ekonomik “Company Zuka Commerce - SHPK”, si palë e pakënaqur, ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për dhënie të kontratës operatorit ekonomik “Euro Abi” nga Ferizaj. Pas pranimit të ankesës OSHP-ja ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të


⁶⁰ http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2011/Mir_Pas_Gjel_Prizren.pdf

shqyrtuar aktivitetin e prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore. Më pastaj, eksperti ka konstatuar se Komuna e Klllokotit ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 59 të LPP-së. Megjithëse komuna nuk është pajtuar me këtë konstatim, Paneli Shqyrtues ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-tenderim**, meqë asnjë operator ekonomik nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Komuna e Fushë Kosovës - ka bërë shkelje ligjore në aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtëpive për banim për familjet e skamnorëve”. Ky aktivitet i prokurimit është kthyer në **ri-vlerësim** për shkak se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë “Bashkimi” nga Drenasi ka pasur çmim më të lartë sesa operatori ankues ekonomik “CTA” nga Prishtina.

Komuna e Mitrovicës - Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik ka kthyer në **ri-vlerësim** tenderin e kësaj komune “Ndërtimi i dy zyrave të vendit në Shupkoc dhe Vinare”. Në këtë tender PSH ka konstatuar se operatori ekonomik “Kalaja” është eliminuar pa të drejtë nga pjesëmarrja - për faktin se në të njëjtin raport bankar shihet qartë se kjo kompani ka qarkullim bankar me tepër se dyfishi i ofertës për projekte identike. Prandaj, me këtë rast autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 dhe 60 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Komuna e Klinës- ka bërë shkelje ligjore në tenderin “Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Cerravik”. Në këtë tender janë eliminuar pa të drejtë tre operatorë ekonomikë⁶¹, ndërkaq vetëm tre të tjerë janë shpallur të përgjegjshëm. Në kuadër të këtyre operatorëve ekonomik ka qenë edhe OE ankues “Haxha Kom”, i cili ka pasur ofertën me çmim më të lirë sesa operatori i rekomanduar për kontratë. Mirëpo, komisioni vlerësues pa të drejtë e ka cilësuar si ofertë me çmim të ulët jashtë normale. Kështu që, duke parë parregullsitë e tilla OSHP-ja ka vendosur që këtë tender ta kthejë në **ri-vlerësim**.



⁶¹ Kompanitw e eliminuara janw: “Haxha Kom”, “Albes” dhe “Kosmaqi”.

Rekomandimet:

1. Lëvizja FOL rekomandon që Qeveria e Kosovës të marrë për bazë rekomandimet e Komisionit Evropian që Ligji i ri i Prokurimit publik të jetë në përputhje me kriteret e BE-së, ku aspiron edhe Kosova të jetë anëtare;
2. Lëvizja FOL rekomandon që Autoritet Kontraktuese të lejojnë qasjen e mbikëqyrjes së shoqërisë civile në procesin e prokurimit publik;
3. Lëvizja FOL i rekomandon Autoriteteve Kontraktuese që vendimet e OSHP-së t'i respektojnë dhe assesi t'i bishtojnë ato apo edhe t'i refuzojnë;
4. Lëvizja FOL i rekomandon OSHP-së dhe AK që të ndërmarrin masa ndëshkuese për zyrtarët e prokurimit që bëjnë shkelje të qëllimshme të dispozitave ligjore dhe atyre të rregulloreve;

Falënderime

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga OSI/CRD. Ky Raport është produkt i stafit të Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ëebfaqe: ëëë.levizjafol.org

Rreth Lëvizjes FOL

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.